

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6234
E hënë, 8 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

Mbahet ceremonia e dërgimit të FSK-së dhe trupave amerikane në mision paqeruajtës | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA), JOE BIDEN, I SHKRUAN LETËR PRESIDENTIT TË SERBISË, ALEKSANDËR VUÇIQ | FAQE 4-5

BIDENI I KËRKON VUÇIQIT TA NJOHË KOSOVËN



Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka kërkuar nga presidenti i Serbisë që të punojë për reforma evropiane dhe për arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Kosovën, duke u

përqendruar në njohjen e ndërsjellë. Kjo kërkesë e tij ishte pjesë e një letre që presidenti Biden i dërgoi presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, me rastin e Ditës së Pavarësisë së Serbisë. Thirrja e Bidenit për njohjen

e Kosovës nga Serbia është mirëpritur nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës. Ndërkaq presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, ka theksuar se qëndrimi i tij në raport me Kosovën nuk ka ndryshuar

OPINION

MOHIMI I GJENOCIDIT ËSHTË THIKË PAS SHPINE VIKTIMAVE TË GJENOCIDIT! F. 11

Bardhyl MAHMUTI



AZIZ KELMENDI EMËR I MADH DHE I LAVDISHËM NË HISTORINË E LUFTËS ÇLIRIMTARE KUNDËR SERBISË PUSHTUESE F. 13

Ismet SYLEJMANI



AKTUALE



Intervistë
RASHIT QALAJ: PRIORITETET E MIA NË KUVEND DO TË LIDHEN ME ÇËSHTJEN E SIGURISË F. 6

AKTIVITETET E PARTIVE POLITIKE NË KUADËR TË FUSHATËS SË ZGJEDHJEVE TË 14 SHKURTIT F. 7


KULTURË

PËR MITRUSH KUTELIN F. 12

Bedri ISLAMI



PARTITË POLITIKE PO GAROJNË ME PROGRAME TË ZGJEDHJEVE TË KALUARA



Njohësi i zhvillimeve ekonomike në vend, njëherësh sekretar i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste, Safet Gërxhaliu, ka thënë se partitë politike edhe në zgjedhjet e 14 shkurtit po garojnë me

programe ekonomike të zgjedhjeve të kaluara si dhe po e kopjojnë njëra-tjetrën në programe. Gërxhaliu ka theksuar se asnjë parti politike nuk e prek rëndësinë e reformës në gjyqësor, sundimin e rendit që është parakusht esencial për zhvillim ekonomik | FAQE 6

PACOLLI THOTË SE COMORS NUK E KA TËRHEQUR NJOHJEN PËR KOSOVËN | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kuba hap ekonominë për bizneset private

HAVANA, 7 SHKURT - Kuba ka njoftuar për reformë në ekonominë e saj që kontrollohet nga shteti. Vendi komunist ka vendosur që t'i lejojë bizneset private të veprojnë në shumicën e sektorëve të ekonomisë. Ministrja e Punës, Marta Elena Feito, tha se vetëm një numër i vogël i sektorëve do të kontrollohen nga shteti.

Ekonomia e Kubës është goditur rëndë nga kufizimet e pandemisë dhe sanksionet amerikane të vendosura nga administrata e ish-presidentit amerikan Donald Trump. Vitin e kaluar ekonomia e Kubës u tkurr për 11 për qind. Kjo shifër shënon rënien më të keqe në pothuajse tri dekada. Banorët e Kubës po përballen me mungesë të produkteve

bazë, transmeton "BBC". Pas rreth 60 vjetësh armiqësi, Shtetet e Bashkuara dhe Kuba relaksuan raportet më 2015 pasi presidenti i atëhershëm i ShBA-së, Barack Obama dhe lideri i Kubës, Raul Castro, ranë dakord t'i normalizonin marrëdhëniet, duke lejuar qytetarët e ShBA-së ta vizitonin ishullin dhe t'i fuqizonin bizneset lokale.



Irani vë kushte për kthim në marrëveshjen bërthamore

TEHRAN, 7 SHKURT - Irani po vë kushte për zbatimin e marrëveshjes bërthamore me fuqitë perëndimore. Lideri Suprem i Iranit, Ajatollah Ali Khamenei, ka thënë se Shtetet e Bashkuara duhet t'i heqin të gjitha sanksionet, nëse duan që Irani të kthehet në marrëveshjen bërthamore. Njoftimi është bërë nga televizioni shtetëror iranian. "Pasi të shohim se sanksionet janë hequr, atëherë ne do t'u kthehemi zotimeve tona", ka thënë Khamenei. Më herët ministri i Jashtëm i Iranit i kërkoi Uashingtonit të



veprojë shpejt për t'u kthyer në marrëveshjen bërthamore të vitit 2015. Ai ka thënë se "koha po kalon për amerikanët", duke

e ndërlidhur me zgjedhjet që pritet të mbahen në qershor në Iran. Parlamenti iranian miratoi një

legjislacion në dhjetor i cili e detyron qeverinë të fuqizojë programin bërthamor, nëse ShBA-ja nuk i lehtëson sanksionet deri më 21 shkurt. "Ne nuk kemi nevojë të kthehemi në tryezën e negociatave. Amerika është ajo që duhet ta gjejë rrugën për të ardhur në tryezë", ka thënë kryediplomati iranian. Ish-presidenti amerikan, Donald Trump, tërhoqi Shtetet e Bashkuara nga marrëveshja bërthamore më 2018 dhe filloi rivendosjen e sanksioneve kundër Iranit. Trumpi pati thënë se marrëveshja ishte e

negociuar keq dhe se ajo i mundësonte Iranit të zhvillojë armë bërthamore. Si përgjigje, Teherani gradualisht ka shkelur pjesë të paktit. Muajin e kaluar Teherani rifilloi pasurimin e uraniumit në 20 për qind - një nivel që kishte arritur para marrëveshjes. Administrata e presidentit Joe Biden po shqyrton mënyrat për t'u kthyer në marrëveshje. Bideni ka thënë se nëse Teherani kthehet në përputhje të plotë me paktin, Uashingtoni do ta pasonte, por Teherani ka thënë se së pari Uashingtoni duhet t'i lehtësojë sanksionet.

ShBA-ja dhe sauditët diskutojnë për luftën në Jemen

UASHINGTON, 7 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken dhe ministri i Jashtëm i Arabisë Saudite, Saudit Faisal bin Farhan, zhvilluan një bisedë në të cilën trajtuan një varg çështjesh, duke filluar nga të drejtat e njeriut dhe deri te lufta në Jemen, tha Departamenti i Shtetit. Blinken gjatë bisedës theksoi përparësitë kryesore të administratës së re amerikane, përfshirë të drejtat e njeriut dhe përfundimin e luftës, tha zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Ned Price, në një deklaratë. Ministri i Jashtëm saudit i ka thënë Blinkenit se Riadi është i etur të bashkëpunojë me administratën e presidentit Joe Biden për ta mbështetur "sigurinë dhe stabilitetin", ka njoftuar Agjencia Zyrtare e Shtypit në Arabinë Saudite.

Kjo është biseda e parë mes kryediplomatit të ri amerikan me homologun e tij saudit, në të cilën u diskutua edhe për antiterrorizmin dhe bashkëpunimin për t'i parandaluar sulmet kundër Arabisë Saudite. Më parë, presidenti amerikan Joe Biden njoftoi se administrata e tij do ta ndalë mbështetjen për "operacionet ushtarake" në Jemen nga ana e koalicionit të udhëhequr nga Arabia Saudite. Shumë ligjvënës demokratë dhe republikanë kanë kërkuar që Uashingtoni t'i japë fund përfshirjes ushtarake në konflikt. Jemeni është përfshirë në një luftë civile më 2015 nga e cila kanë mbetur të vrarë më shumë se 100 000 njerëz. Shumica e popullsisë në Jemen është në prag të urisë



Britania e Madhe përgatitet për borë dhe acar



Londër, 7 shkurt - Njerëzve po u kërkohet t'i mbajnë nën kontroll të moshuarit dhe personat e sëmurë, ndërsa i ftohti dhe bora kërcënojnë të shkaktojnë probleme në Britaninë e Madhe. Një

paralajmërim për borë është lëshuar në Anglinë lindore dhe juglindore dhe do të mbetet në fuqi deri mëngjesin e të hënës. Paralajmërimet për borë dhe akull po ashtu janë lëshuar në pjesën më të madhe të Anglisë,

Skocisë dhe Uellsit Lindor. Pjesë të Skocisë kanë regjistruar ndërkohë reshje të mëdha bore ditët e shkuara, me mbi 50 cm borë në disa zona. Ekspertët paralajmërojnë për probleme në udhëtime dhe një shans të

vogël për ndërprerje të energjisë elektrike ose izolim të ndonjë komuniteti në zonën lindore dhe perëndimore të Londrës, në juglindje, veriperëndim dhe jugperëndim të Uellsit.

Mbahet ceremonia e dërgimit të FSK-së dhe trupave amerikane në mision paqeruajtës

PRISHTINË, 7 SHKURT - Në qytetin Xhonston të shtetit të Aiovas në ShBA është mbajtur ceremonia e organizuar me rastin e dërgimit të përbashkët të trupave nga Forca e Sigurisë Kosovës dhe Garda Kombëtare e Aiovas në mision paqeruajtës.

Në një adresim përmes videos, komandanti i Forcave të Sigurisë së Kosovës, Rrahman Rama, ka thënë se ky është një moment historik për vendin. "Faleminderit popullit të Aiovas si dhe udhëheqësve si në nivel shtetëror, po ashtu edhe në atë federal, për

besimin ndaj të arriturave të FSK-së dhe popullit të Kosovës", ka thënë Rama.

Kim Reynolds, guvernatore e Aiovas, vlerësoi përkushtimin e këtyre forcave për lirinë, duke i falënderuar për sakrificën dhe shërbimin.

Më 6 janar komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Rrahman Rama, ka thënë se për dërgimin e misionit paqeruajtës në shqyrtim janë dy vende. "Për vende i kemi dy opsione, Kuvajtin dhe Irakun, por presim që shumë shpejt ta konfirmojmë këtë. Sado të jetë simbolike, pjesëmarrja jonë

është shumë e rëndësishme për FSK-në dhe Kosovën", ka deklaruar Rama.

"Radio Evropa e Lirë" ka mësuar nga zyrtarë shtetërorë se opsioni i Irakut është më pak i mundshëm, pasi ky shtet ende nuk e ka njohur Kosovën.

Më 5 janar Kuvendi i Kosovës pati votuar vendimin për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

Një ditë pas miratimit në Kuvend, ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, e ka nënshkruar autorizimin për dërgimin e kontingjentit të

FSK-së në mision paqeruajtës. Kurse më 31 dhjetor të vitit të kaluar (2020), Qeveria e Kosovës pati miratuar vendimin për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në misione jashtë vendit.

FSK-ja deri më tani nuk ka marrë pjesë në operacione paqeruajtëse jashtë vendit. Shumë shtete, duke përfshirë ShBA-në, Britaninë e Madhe, Turqinë, e kanë mbështetur FSK-në me pajisje ushtarake dhe trajnimin e kuadrit të saj profesional.

Kosova ka partneritet shtetëror

me Ajovan, Garda Kombëtare e së cilës ndihmon FSK-në në ngritjen e saj dhe konsolidimin në ushtri.

Në vitin 2018 Kuvendi i Kosovës ka miratuar ndryshimet ligjore për transformimin e mandatit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në forca të armatosura. Sipas legjislacionit, është paraparë që procesi i transformimit në Ushtrinë e Kosovës të zgjasë dhjetë vjet.

Aktualisht, FSK-ja ka 2 747 ushtarë aktivë, ndërsa synimi është që kjo forcë të ketë 5 000 ushtarë aktivë dhe një forcë rezervë prej 3 000 vetash.



Pacolli thotë se Comors nuk e ka tërhequr njohjen për Kosovën

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka thënë se ka pranuar një letër nga ministri i Punëve të Jashtme i Comorsit dhe se ai e ka siguruar që njohja e arritur vazhdon e paprekur dhe e shëndoshë. Pacolli ka pohuar se "propaganda parapolitike serbe ka tentuar shumë që të ndikojë në këtë shtet që ta tërheqë njohjen dhe ta zhbëjë punën tonë". "Miqësitë e vendosura

nga ne janë të pazhbëshme, sepse janë produkt i punës, angazhimit dhe dashurisë për vendin. Prandaj ministri i Comors më shkruan se lajmet janë të pavërteta dhe njohja e ndërsjellë vazhdon e paprekur. Përkundër se aktualisht nuk jam në pozitë zyrtare si ministër i Punëve të Jashtme dhe as nuk mbaj post tjetër qeveritar, letra më është dërguar mua", ka shkruar Pacolli në rrjetet sociale.



Nga 2 291 testime, 249 raste me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 7 SHKURT - Të dielën në Kosovë janë shënuar edhe 249 raste të reja me Covid-19. Rezultatet janë në bazë të 2 291 mostrave të testuara. Më së

shumti raste janë regjistruar në Komunën e Prishtinës. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka njoftuar se nga sëmundja kanë vdekur edhe

tre pacientë, duke e çuar numrin e përgjithshëm të vdekjeve në 1 523. Të shëruar janë regjistruar edhe 274 pacientë, ndërsa raste aktive

aktualisht janë 6 693. Rastet e para me koronavirus në Kosovë janë regjistruar në muajin mars të vitit 2020, në kohën kur u shpall pandemia e

Covid-19. Deri më tani autoritetet shëndetësore kanë regjistruar gjithsej 62 258 persona të infektuar, prej të cilëve 54 042 janë shëruar.



PRESIDENTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA), JOE BIDEN, I SHKRUAN LETËR PRESIDENTIT TË SERBISË, ALEKSANDËR VUÇIQ

BIDENI I KËRKON VUÇIQIT TA NJOHË KOSOVËN

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka kërkuar nga presidenti i Serbisë që të punojë drejt reformave evropiane dhe për arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Kosovën të përqendruar në njohjen e ndërsjellë. Kjo kërkesë e tij ishte pjesë e një letre që presidenti Biden i dërgoi presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, me rastin e ditës së pavarësisë së Serbisë. Thirrja e Bidenit për njohjen e Kosovës nga Serbia është mirëpritur nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës. Ndërkaq presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, ka theksuar se qëndrimi i tij në raport me Kosovën nuk ka ndryshuar

zgjidhje përfundimtare, por është detyrim i tij t'i mbrojë interesat serbe.

Duke komentuar letrën që presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, i ka dërguar atij me rastin e Ditës së Shtetësisë së Serbisë, e në të cilën ai inkurajon Serbinë të ndërmarrë reforma dhe të "arrijë marrëveshje gjithëpërfshirëse të normalizimit me Kosovën, e cila përqendrohet në njohjen e ndërsjellë", Vuçiqi ka thënë se çështja e njohjes nuk përmendet në asnjë dokument. "Kam pranuar urimin. E falënderoj. Sa i përket njohjes, ajo nuk përmendet në asnjë dokument. Ne e kuptojmë se kjo është politikë e re amerikane. Ka pasur përpjekje për të imponuar këtë frazë. Ua

kam thënë në fytyrë se çfarë mendoj në lidhje me të dhe qëndrimi im nuk do të ndryshojë. Është e qartë se qëllimi i tyre nuk është arritja e një marrëveshjeje, por poshtërimi deri në fund i Serbisë", ka deklaruar Vuçiqi të dielën, gjatë një vizite në një kazermë të ushtrisë serbe në Pançevë.

Vuçiqi ka shtuar se Serbia është e gatshme për dialog me Kosovën të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, duke respektuar pozicionin e ShBA-së, por edhe të Rusisë dhe Kinës, si dhe të vet Serbisë. "Unë nuk do të lejoj që të poshtërohet Serbia dhe dikush të marrë gjithçka. Por, unë nuk do ta gënjej popullin dhe të them se situata do të jetë e lehtë. Do të jetë gjithnjë e më e vështirë", ka thënë Vuçiq.

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka thënë se Shtetet e Bashkuara mbesin të palëkundura në qëllimin për ta mbështetur integritimin evropian të Serbisë, mirëpo ka kërkuar reforma dhe arritjen e një marrëveshjeje me

Kosovën e cila përfshin njohjen e ndërsjellë. "Ju inkurajojmë të vazhdoni të ndërmerrni hapa të vështirë për të arritur atë qëllim, përfshirë realizimin e reformave të nevojshme dhe arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të normalizimit me Kosovën, e cila përqendrohet në njohjen e ndërsjellë", thuhet në një letër të cilën presidenti Biden i ka

dërguar presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, me rastin e Ditës së Shtetësisë së Serbisë që shënohet më 15 shkurt. Letra është publikuar në faqen zyrtare të Presidencës së Serbisë.

Ndërkaq presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se ka pasur përpjekje që "njohja e ndërsjellë" në mes të Kosovës dhe Serbisë të imponohet si



Kosova mirëpret letrën e Bidenit dërguar Serbisë për njohjen e Kosovës

Avdullah Hoti, ka thënë se letra e presidentit Biden për Serbinë vulosi miqësinë Kosovë - ShBA. "ShBA-ja mbetet aleatja më fuqiptotë e Kosovës Nga Shtëpia e Bardhë vazhdojnë të vijnë vetëm lajme të mira për Kosovën. Letra e presidentit Biden, dërguar presidentit të Serbisë për njohjen e Kosovës, është edhe një dëshmi për lidhjen e veçantë midis dy vendeve, miqësinë e përjetshme për të cilën fliste presidenti Rugova sa herë që thoshte se shtëpia nuk mbahet pa miq. Marrëveshja e 4 shtatorit 2020 ishte vetëm fillimi i një etape të re të partneritetit strategjik që ShBA-ja ka me Republikën e Kosovës. Ne do ta thellojmë edhe më tej këtë partneritet. Kosova vazhdon të mbetet prioritet në agjendën e ShBA-së", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka mirëpritur letrën që presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, i ka dërguar presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, përmes së cilës ka kërkuar njohje reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë. Haradinaj-Stublla e vlerëson këtë si një arritje në pozicionin e palëkundur të Kosovës për përmbylljen e dialogut final me Serbinë me njohje të pakushte të pavarësisë së Kosovës, duke

respektuar parimet e pandryshueshme për karakterin unitar, integritetin territorial dhe rendin kushtetues. "Si ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës kam kërkuar në vazhdimësi rol aktiv e përcaktues të ShBA-së në dialogun final me Serbinë. Vetëm me përfshirjen e ShBA-së, me qëndrimin e tyre të palëkundur se duhet të ketë njohje reciproke, mund të arrihet marrëveshja finale e cila do të kontribuonte në paqen dhe stabilitetin e rajonit dhe më gjerë", ka thënë ministrja Haradinaj-Stublla, duke vënë në pah rëndësinë e pranisë amerikane dhe rolin e saj aktiv të dëshmuar në të gjitha proceset e rëndësishme për Kosovën. "Pa rolin aktiv dhe përcaktues të ShBA-së si aktor kryesor dhe administratën e presidentit Biden do të jetë vështirë të paramendohet një marrëveshje e qëndrueshme që garanton njohjen reciproke mes dy shteteve", ka thënë ministrja Haradinaj-Stublla.

Këtë letër të Bidenit e ka mirëpritur lideri i PDK-së, Enver Hoxhaj, i cili ka pohuar se ky është një zhvillim tepër i rëndësishëm pasi Ballkani Perëndimor mund të ecë përpara në rrugën e saj të integritetit evropian vetëm kur të zgjidhen të gjitha mosmarrëveshjet. "Faleminderit Joe Biden që edhe një herë keni përsëritur se Kosova dhe Serbia

duhet të arrijnë një marrëveshje përfundimtare të përqendruar në njohjen reciproke! Ky është një zhvillim tepër i rëndësishëm pasi Ballkani Perëndimor mund të ecë përpara në rrugën e integritetit evropian vetëm kur të zgjidhen të gjitha mosmarrëveshjet", ka shkruar Hoxhaj në "Twitter".

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, e ka mirëpritur letrën e Bidenit drejtuar Serbisë për njohje të Kosovës. "Falënderoj presidentin Biden për qëndrimin konsistent lidhur me Kosovën, ndërsa Vuçiq do të marrë përgjigjen për kufijtë më 14 shkurt", ka thënë Haradinaj nëpërmjet një videoje të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka mirëpritur letrën e presidentit amerikan Joe Biden, nëpërmjet së cilës kërkon nga presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, njohjen e shtetit të Kosovës nga Serbia. "Mirëpres letrën e presidentit Biden që kërkon nga Vuçiqi pranimin e pavarësisë së Kosovës. Tani është radha jonë. Ne na duhet që të zgjedhim udhëheqës të denjë, që do të luftojnë për interesin tonë nacional në luftën diplomatike që po na pret. Serbia duhet ta njohë Kosovën, por jo me kushtin e heshtjes dhe me mohimin e gjenocidit", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Thirrja e Bidenit për njohje të ndërsjellë është mirëpritur nga autoritetet në Kosovë. Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, tha se "është pa dyshim e qartë se e vetnja rrugë përpara në dialog është

marrëveshja për njohje reciproke". "Një qasje e munguar që nga fillimi i dialogut - një qasje e nevojshme për përfundimin e tij me sukses", ka shkruar Osmani në rrjetin social "Twitter". Edhe kryeministri në detyrë,

DnV-ja: Me grumbullime, partitë po rrezikojnë jetën e qytetarëve

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Koalicioni i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve Demokracia në Veprim e ka dënuar ashpër "papërgjegjësinë e subjekteve politike të cilat po vënë në rrezik shëndetin dhe jetën e qytetarëve", duke organizuar tubime të fushatës parazgjedhore pavarësisht prej masave ndaj pandemisë. "Grumbullimet e mëdha pa përfillje të masave mund të shkaktojnë pasoja të cilat institucionet nuk do të mund t'i përballojnë as në aspektin shëndetësor dhe as në atë ekonomik. DnV iu bën thirrje subjekteve politike që t'i respektojnë në mënyrë rigorozë të gjitha masat anti-Covid gjatë zhvillimit të

aktiviteteve të tyre. Gjithashtu, DnV-ja kërkon nga inspektoratet komunale të shqiptojnë dënime për të gjithë shkelësit pa përjashtim", thuhet në deklaratën e këtij koalicioni të organizatave joqeveritare, të cilët kanë shpallur të shtunën të gjeturat e monitorimit të tri ditëve të para të fushatës së partive politike për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit në Kosovë.

Jeta Krasniqi nga DnV-ja ka njoftuar se monitorimi i fushatës zgjedhore po bëhet në shtatë qendrat më të mëdha të Kosovës dhe komunat me shumicë serbe me anë të angazhimit të 16 vëzhguesve afatgjatë. Për shkak të pandemisë së



koronavirusit, në Kosovë nuk lejohen tubime në ambiente të mbyllura me më shumë se 30 persona, si dhe ndalohen të gjitha tubimet që kanë më shumë se 50 pjesëmarrës. Mirëpo të dyja rregullat janë

shkelur me nisje të fushatës zgjedhore më 3 shkurt. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të mbahen më 14 shkurt. Fushata zgjedhore e subjekteve politike, sipas Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve, do të zgjasë prej 3 shkurtit e deri më 12 shkurt. Në garën për 120 ulëset e Kuvendit të Kosovës do të garojnë 28 subjekte politike me mbi 1 000 kandidatë për deputetë.

Flet për “Epokën e re” kandidati për deputet, Rashit Qalaj

Prioritetet e mia në Kuvend do të lidhen me çështjen e sigurisë

Ish-drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, njëherësh kandidat për deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Rashit Qalaj, është shprehur se qytetarët e Kosovës çdo ditë e më shumë po i bashkëngjiten programit për rimëkëmbje. Sipas tij, fitorja e PDK-së është e pashmangshme në zgjedhjet e 14 shkurtit. Qalaj në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, zotohet se kërkesat e qytetarëve do të trajtohen me seriozitet në Kuvendin e Kosovës. Ai ka theksuar angazhimin e rezervë për ofrimin e një sigurie më të madhe me një ushtri më të fortë dhe me një polici efikase



PRISHTINË, 7 SHKURT -

“Epoka e re”: E kaluara juaj është e njohur për publikun, pasi që në periudha të rëndësishme për Kosovën ju keni dhënë kontribut të jashtëzakonshëm si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më pas si pjesëtar dhe drejtues i institucionit të sigurisë, Policisë së Kosovës. Na tregoni si e kanë prituri qytetarët inkuadrimit tuaj në politikë?

Rashit Qalaj: Të them të drejtën kam vërejtur mendime të ndryshme. Disa qytetarë të cilët më kanë kontaktuar kanë shprehur keqardhje për faktin që kam dhënë dorëheqje nga policia, pasi ata mendojnë se e kam udhëhequr policinë në mënyrë shumë të suksesshme dhe se është dashur që unë të luftoj nga brenda sistemit dhe ta pres vendimin e gjykatës, në mënyrë që të kthehem në pozitën e drejtorit. Pjesa tjetër mendon se kam vepruar drejt dhe në momentin e duhur, është bindur se nga politika mund të kem më shumë mundësi që të veprojmë dhe t'i ndihmojmë institucionet e sigurisë, duke ndaluar degradimin e tyre, ta sjell ligjshmërinë në emërimin e drejtuesve, sidomos në polici. Dhe, po ashtu, t'i bëjmë këto institucione më të pavarura dhe më efikase në ofrimin e shërbimeve të tyre për qytetarët e Republikës së Kosovës.

“Epoka e re”: Gjatë këtyre ditëve keni pasur rastin të takoheni me qytetarë të shumtë nga vende të ndryshme të Kosovës. Cilat janë kërkesat më të shpeshta të tyre e që lidhen me prioritetet e juaja për të cilat edhe i keni hyrë këtyj rrugëtimi politik?

Rashit Qalaj: Po, është e vërtetë se jam duke kontaktuar e duke

takuar shumë qytetarë pasi që është edhe fushatë zgjedhore dhe të gjithë ata kërkojnë që deputeti i ardhshëm i Kuvendit të Kosovës të jetë zëri i tyre, që të jemi aktivë dhe shumë të kujdesshëm kur të vijë momenti i votimit të ligjeve, që këto ligje të jenë konform kërkesave dhe nevojave të qytetarëve dhe të vendit dhe të mos votohen ligje sipas nevojave private të ndonjë politikani apo ndonjë partie politike. Po ashtu, kërkesë e tyre është që unë të kujdesem dhe të angazhohem shumë për institucionet e sigurisë.

“Epoka e re”: A mendoni që profesioni që keni ushtruar deri më tani si polic dhe drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës ju ka ndihmuar për t'i njohur dhe për t'iu qasur më lehtë divergjencave në politikë dhe jo vetëm?

Rashit Qalaj: Pa dyshim që më ka ndihmuar pasi që kam pasur rastin që nga jashtë t'i analizoj këto divergjenca e që, sipas mendimit tim, nuk kanë të bëjnë aq shumë me nevojat e qytetarëve mirëpo, në të shumtën e rasteve, këto divergjenca janë çështje ideologjish apo çështje liderësh.

“Epoka e re”: Në momentin që iu keni bashkuar politikës, te qytetarët keni reflektuar si një politikan që nuk keni appetite personale në politikë, por si një politikan i cili ka shprehur vullnet për të çuar tutje kauza që janë në favor të vendit. Sa ju bën përgjegjës një vlerësim i tillë?

Rashit Qalaj: Mendoj se inkuadrimi im në politikë është duke u vlerësuar shumë nga qytetarët dhe ky vlerësim më bën përgjegjës pasi që do të angazhohem me tërë qenien

time të shtyj përpara në Kuvend kauza që janë në favor të vendit, në favor të qytetarit që gjithmonë do ta kem në plan ta parë qytetarin e Kosovës dhe nevojat e tyre. Dhe, po ashtu, do të jem gjithmonë i gatshëm të jap llogari para votuesve të mi dhe qytetarëve të Kosovës për aktivitetin tim nga pozicioni i deputetit të Kuvendit të Kosovës. Në këtë fushatë elektorale, në çdo tubim me qytetarët, jam duke premtuar llogaridhënie dhe takime me ta në mënyrë të rregullt.

“Epoka e re”: Cili është apo cili do të jetë relacioni juaj me Policinë e Kosovës, meqenëse keni dhënë kontribut të rezervë në këtë institucion për gati 21 vjet?

Rashit Qalaj: Unë, pavarësisht faktit se zyrtarisht më nuk jam pjesë e Policisë së Kosovës, gjithmonë në zemrën time do të mbetem polic dhe do të jem zëri i tyre kudo dhe kurdo që është e nevojshme. Prioritetet e mia lidhen me Policinë e Kosovës, me zjarrfikësit dhe me Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, me IPK-në si dhe me Agjencinë e Regjistrimit Civil. Këto prioritetet do t'i specifikoj në: 1. Policia ka nevojë urgjente për ligjin e pensionimit të

parakohshëm, për sigurime shëndetësore dhe jetësore, për një proces të vetingut, të vazhdohet projekti i BE-së për reforma në polici. Policia ka nevojë për buxhet shtesë, t'u ngritën pagat policëve, të forcohet dhe të avancohet Task-Forca antikorupsion, të shqyrtohet statusi i stafit civil në Policinë e Kosovës etj. 2. Zjarrfikësve t'u rregullohet statusi i tyre, t'u shtohet buxheti, t'u ngritën pagat, urgjentisht t'u blihen pajisje të reja, t'u krijohet kushte më të mira të punës, t'u përmirësohet infrastruktura e sidomos t'u sigurojmë makina të reja për shuarjen e zjarrit. 3. AME-ja të përforcohet me personel, të ngritën kapacitetet në saje të veprimt, të krijohet një brigadë e në kuadër të saj t'i kemi njësitë përkatëse të trajnuara dhe të pajisura mirë për reagim emergjent qoftë nga fatkeqësitë e shkaktuara nga natyra apo dora e njeriut. Të krijohet një fond i konsiderueshëm për raste të reagimit emergjent. 4. IPK-ja ka nevojë për ligj të parakohshëm të pensionimit, për një proces të mirëfilltë të vetingut, të rishqyrtohen dhe hetohen proceset e kompromituara të punësimit, t'i ngritën buxheti, të ketë pajisje

më të sofistikuara për hetime. 5. Agjencia e Regjistrimit Civil nuk guxon që të ketë pengesa siç ka pasur deri më tani për ofrimin e shërbimeve për qytetarë, si nxjerrja e dokumenteve të identifikimit dhe dokumenteve të udhëtimit apo të regjistrimit të veturave. Shumë shërbime duhet që të kalojnë online, ka nevojë për infrastrukturë shtesë, buxhet shtesë etj.

“Epoka e re”: Tanimë zyrtarisht jeni kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës. Cili është mesazhi juaj për qytetarët e Kosovës?

Rashit Qalaj: Me Partinë Demokratike të Kosovës, qytetarëve të Kosovës do t'u sigurohet rimëkëmbja ekonomike, do të ngritet mirëqenia, do të ketë arsim më të mirë dhe më cilësor, do të ketë shëndetësi më të mirë, sistem të drejtësisë më efikas, do të ketë siguri më të madhe me një ushtri më të fortë dhe polici me efikase për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Gjithashtu, do të ketë avancim të sportit, kulturës e artit. Pra, do të kemi një rimëkëmbje të gjithëmbarshme.

(Intervistoi: Mihane Hoxha)

Aktivitetet e partive politike në kuadër të fushatës së zgjedhjeve të 14 shkurtit

Hoxhaj: Për mua dhe PDK-në, Berlioni mbetet adresa më e rëndësishme politike në Evropë

PRISHTINË, 7 SHKURT - Kandidati për kryeministër nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka dhënë një intervistë për radion publike gjermane "Deutschlandfunk", në të cilën ka folur për zgjedhjet e 14 shkurtit dhe programin që ofron partia që drejton. Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se për të dhe PDK-në, Berlioni mbetet adresa më e rëndësishme politike në Evropë. "Për radion publike gjermane 'Deutschlandfunk', e cila është radio e preferuar e diasporës sonë në Gjermani, fola për prioritetet tona në këto zgjedhje, për planin ekonomik, për politikën e jashtme, marrëdhëniet me Berlinin, investimet gjermane në Kosovë dhe për tema të tjera me interes. Këto zgjedhje janë test i orientimit tonë perëndimor, demokracisë sonë, tregut dhe mediave të lira. Për këtë,

Hoti 'godet' LV-në: Ne nuk paguajmë ekspertë për t'i fshirë deklaratat e 15 vjetëve

MITROVICË, 7 SHKURT - Kandidati për kryeministër nga LDK-ja, Avdullah Hoti, në tubimin e mbajtur në Mitrovicë është shprehur se kur kanë marrë për ta drejtuar qeverinë në qershorin e 2020-s e kanë shpëtuar Kosovën nga shkatërimi. Hoti në këtë tubim elektorale ka folur për Lëvizjen Vetëvendosje, duke thënë se ajo ka kundërshtuar të gjitha proceset e shtetndërtimit. "Ne nuk angazhohim ekspertë për t'i fshirë deklaratat se çfarë kemi thënë 15 vjet", ka thënë Hoti. Ai ka thënë se integriteti territorial i Kosovës me LDK-në në qeveri do të jetë i pangeciueshëm. Ndërkaq në tubimin elektorale në Vushtrri, Hoti ka thënë se Vushtrria është

mbështetjen e shtetit", ka thënë Hoti.

Limaj: Zëri i çlirimtarëve do të jehojë fuqishëm në Kuvendin e Kosovës

MALISHEVË, 7 SHKURT - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka vazhduar takimet e shumta me mbështetësit e tij nëpër fshatrat e Malishevës. Ai ka thënë se kauza për çlirimtarët po merr mbështetje të madhe. "Kauza jonë 'Me Çlirimtarët' mbrëmë mori mbështetje të jashtëzakonshme në fshatrat Mirushë, Burim dhe Carrallukë të Malishevës", ka thënë Limaj, i cili është shprehur tejet mirënjohës ndaj bashkëlloftëtarëve dhe mbështetësve të rinj të këtyre fshatrave që janë rreshtuar fuqishëm krah frymës së Nismës për zgjedhjet e 14 shkurtit. "Falë kontributit të madh që qytetarë të shumtë anekënd vendit po i japin Nismës Socialdemokrate, pas 14 shkurtit zëri i çlirimtarëve do të jehojë fuqishëm në Kuvendin e Kosovës", është shprehur Limaj.

Kurti: Sot një javë të dalim në zgjedhje që fatin e Kosovës ta marrim në duart tona

PRIZREN, 7 SHKURT - Kandidati për kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje, Albin Kurti, nga qyteti i Prizrenit ka thënë se do të dalin të parët në zgjedhjet e 14 shkurtit. Kurti ka përsëritur se kësaj here u nevojitet një fitore e madhe, me mbi 61 deputetë, teksa ka bërë thirrje që sot një javë secili të dalë në zgjedhje. "Nga Prevala, Mushnikova e Lubizhda, tutje në Zhur, Poslishtë, Terzimahallë, Islahanë dhe Bajram Curr, të gjithë ishin të mobilizuar. Se në Prizren gjithmonë dalim të parët, kjo dihet. Por kësaj here na nevojitet fitore e madhe, me



mbi 61 deputetë. Andaj, sot një javë të dalim në zgjedhje secili e secila, që fatin e Kosovës ta marrim në duart tona", është shprehur Kurti.

më latë vetëm! Të dashur qytetarë të diasporës shqiptare, ky moment historik për Kosovën natyrshëm se është i përbashkët për ne. Ju jam skajshmërisht mirënjohës të gjithëve për



qytetarët dhe diaspora jonë duhet të votojnë për PDK-në, e cila është diga e vetme kundër autoritarizmit në Kosovë. Këto zgjedhje janë të rëndësishme edhe për Berlinin se kënd do ta kenë partner në krye të Qeverisë së Kosovës. Askush më mirë se Berlioni nuk e njeh rrezikun e populistëve dhe retorikës përçarëse. Për mua dhe PDK-në, Berlioni mbetet adresa më e rëndësishme politike në Evropë", ka shkruar Hoxhaj.

e vendosur që ta mbështesë këtë parti në zgjedhjet që do të mbahen sot një javë. "Qeveria jonë ka një plan të qartë për zhvillimin e saj. Ne e kemi aprovuar masterplanin për ujitjen e tokave bujqësore për gjithë Kosovën, përfshirë edhe komunën e Vushtrrisë. I kemi dyfishuar subvencionet në bujqësi dhe kemi vendosur që t'i lirojmë bujqit nga pagesa për ujitje të tokave bujqësore. Me qeverisjen e LDK-së, qytetarët do të vazhdojnë ta ndiejnë



Haradinaj merr përkrahje nga diaspora

PRISHTINË, 7 SHKURT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), njëherësh kandidati për president, Ramush Haradinaj, ka marrë mbështetje nga diaspora. Ai ka postuar një fotografi në llogarinë e vet në "Facebook" me përkrahjen që po i vjen nga diaspora për zgjedhjet e 14 shkurtit. "Mirënjohje për ju që kurrë nuk

mbështetjen, pa dallim. Ju mijëra bashkatdhetarë që po e përkrahni vizionin tonë, ashtu si dikur, kur Kosova dhe unë kishim nevojë për ju, nuk na latë vetëm për asnjë moment! Pak ditë na ndajnë nga referendumi historik, ku përcaktohet se çfarë drejtimi po merr vendi ynë. Andaj, ju lus që edhe një herë si gjithmonë të bëhemi bashkë e ta fitojmë edhe këtë betejë. 14 shkurti është drejtimi i vendit tonë, andaj bëhuni pjesë e tij", ka shkruar Haradinaj.





Flet për “Epokën e re”, Safet Gërxhaliu

Partitë politike po garojnë me programe të zgjedhjeve të kaluara

Njohësi i zhvillimeve ekonomike në vend, njëherësh sekretar i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste, Safet Gërxhaliu, ka thënë se partitë politike edhe në zgjedhjet e 14 shkurtit po garojnë me programe ekonomike të zgjedhjeve të kaluara si dhe po kopjojnë në programe njëra-tjetrën. Gërxhaliu ka theksuar se asnjë parti politike nuk e prek rëndësinë e reformës në gjyqësor, sundimin e rendit që është parakusht esencial për zhvillim ekonomik. “Deri më tani sa i kam analizuar programet e partive politike, kam parë se në këto programe mund ta gjeni vetëm një të vërtetë: ata luftojnë për pushtet dhe jo për shtet. Pra, luftohet për votë dhe jo për zbatim të premtimeve. Kjo do ta përcjell Kosovën me vite të tëra”, ka thënë Gërxhaliu

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 SHKURT - “Epoka e re”: Z. Gërxhaliu, tanimë fushata zgjedhore ka filluar. Sa keni mundur t’i shihni programet ekonomike të partive politike për zgjedhjet e 14 shkurtit?

Gërxhaliu: Kampanja zgjedhore e vitit 2021 ka filluar me një agresivitet të paparë, duke marrë parasysh se jemi në një kohë të pandemisë dhe po shihen tubimet partiake me plot qytetarë, e kjo bie ndesh me të gjitha parimet e OBSH-së dhe të institucioneve të vendit. Me këtë formë të kampanjave zgjedhore dhe numër të madh të takimeve, Kosova është shndërruar në një hapësirë eksperimentale të botës civilizuese. Bota e

zhvilluar është duke u izoluar si formë e mbrojtjes nga pandemia, ndërkaq në Kosovë shkelen masat anti-Covid nga vetë ata që i prezantojnë. Kjo është shqetësuese. Sa iu përket programeve të partive politike, mund t’ju them se është një përsëritje nga zgjedhjet e kaluara dhe, po ashtu, kemi kopjim të programeve të partive politike nga njëra-tjetra. Partitë politike shumë më tepër merren me elaburime ekstreme sesa me zgjidhje konkrete. Është e vërtetë se termet si rritja e buxhetit, pushimet e lehonisë, paga mesatare dhe paga minimale, janë tema që dominojnë edhe nga e kaluara, të cilat janë bartur edhe sot, sepse ato probleme ende nuk janë zgjidhur. Mirëpo, askush nuk

e prek rëndësinë e reformës në gjyqësor, sundimin e rendit që është parakusht esencial për zhvillim ekonomik. Në këtë drejtim ka hezitim.

“Epoka e re”: Sa i përket privatizimit të Telekomit, “Trepçës” dhe ndërmarrjeve të tjera publike, me çfarë optike i shihni këto programe?

Gërxhaliu: Në të gjitha vendet normale ndërmarrjet publike janë pjesë e ndërtimit dhe fuqizimit të shtetit, por në Kosovë janë barrë e shtetit. Në këtë drejtim sfida më e madhe nuk do të jetë pushimi i lehonisë dhe buxheti, por sfid mbetet reformimi i administratës publike sepse kemi administratë të mbingarkuar, të politizuar dhe joprofesionale e cila gjeneron korrupsion,



vetme për rininë është ikja nga Kosova. Nëse ky do të jetë version edhe në të ardhmen, besoj se është dënimi më i madh që po iu bëhet qytetarëve të Kosovës.

“Epoka e re”: Çfarë përfitimesh ekonomike mund të kemi nga marrëveshja me Izraelin dhe ku duhet të koncentrohemi në këtë aks?

Gërxhaliu: Në Kosovë jepen deklarata pa bërë një analizë të studiuar. Marrëveshja e Uashingtonit më 4 shtator ishte një nga pikat më të mëdha në shumë aspekte. Duhet të kuptohet se ajo marrëveshje ka në vete parimet e saj. Çdo parim duhet të shndërrohet në marrëveshje. Në këtë drejtim ka qenë edhe marrëveshja për krijimin e marrëdhënieve ekonomike me Izraelin, që në aspektin ekonomik është i pakontestuar, kurse në aspektin strategjik është perfekt i dizajnuar. Në aspektin e promovimit të Kosovës është vërtet një mekanizëm që duhet të promovohet. Në këtë drejtim duhet t’u jemi mirënjohës ShBA-së për këtë ndihmë. Në fund të fundit, jo vetëm Izraeli, por asnjë vend që e ka njohur Kosovën nuk e ka bërë këtë pa miratimin e ShBA-së, Britanisë së Madhe, Gjermanisë dhe Francës. Prandaj po e shihni sa i rëndësishëm qenka partneriteti me shtetet mike që ishin sponsorizuese të pavarësisë. Fati i ardhshmërisë së Kosovës është i lidhur me qasjen e tyre. Në këtë drejtim besoj se nëse diçka e ka karakterizuar vitin 2020-2021, është nënshkrimi i marrëveshjes në Uashington dhe vënia e marrëdhënieve diplomatike me Izraelin që është një superfuqi ekonomike. Për ta ilustruar këtë superfuqi po them vetëm një fakt. Në vitin 2020, derisa Kosova me shumë mund e kaloi në Kuvend buxhetin prej 2 miliard e 430 milionë eurosh, Izraeli e miratoi buxhetin prej 121 miliardë eurosh dhe orientimin e ka në dije, në inovacion, teknologji inovative dhe ngritjen e resurseve humane. Ky është një model që duhet të ndiqet. Besoj se është obligim moral i qeverisë së re që ta formojë një trup të veçantë për partneritetet me Izraelin, pra një trup politik, ekonomik dhe kulturor, në mënyrë që këtë partneritet ta promovojë në masë enorme edhe për shtetet e tjera që nuk e kanë njohur Kosovën.

kriminalitet dhe burokraci. Një kryeministër adekuat do të duhej të na tregonte se si do të zgjidhen problemet akute në këto ndërmarrje. Për mua guxim intelektual i një kryeministri është nëse ai del dhe e trajton çështjen e zgjidhjes së problemit të Telekomit të Kosovës, si do ta zgjidhë problemin e “Trepçës”, të një ndërmarrje e cila ka rëndësi të pakontestuar politike, integruese, ekonomike dhe strategjike. Pra, na duhet një kryeministër që nuk i mungon guximi për t’u përballur me realitetin që ekziston në Kosovë.

“Epoka e re”: Dhe nga kjo që po thoni asnjë parti në programet e veta nuk e ka prekur sa duhet zhvillimin ekonomik?

Gërxhaliu: Deri më tani, sa i kam analizuar programet e partive politike, kam parë se në këto programe mund ta gjeni vetëm një të vërtetë: ata luftojnë për pushtet dhe jo për shtet. Pra, luftohet për votë dhe jo për zbatim të premtimeve. Kjo do ta përcjellë Kosovën me vite të tëra. Prandaj nuk duhet të habitemi se 20 vjet pas luftës jemi këtu ku jemi. Në aspektin social zgjidhja e

Greqia kërkon 65 mijë punëtorë, shqiptarët pëlqejnë punën në bujqësi, blegtori dhe turizëm



PRISHTINË, 7 SHKURT - Greqia kërkon zyrtarisht 65 mijë punëtorë sezonalë. Të parët që preferohen janë shtetasit nga Shqipëria të cilët janë edhe grupi më i madh i emigrantëve në vendin fqinj. Është publikuar në Fletoren Zyrtare vendimi për lejet e qëndrimit që do t’u jepen punëtorëve të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në Greqi. Për herë të parë qeveria greke ka vendosur që, përveç punëtorëve që marrin leje qëndrimi çdo vit në Greqi, në bazë të ligjeve në fuqi, të vendosë edhe kuotat e punëtorëve sezonalë që do të

kenë të drejtë të punësohen në çdo sektor, më konkretisht 65 mijë në bujqësi dhe rreth 10 mijë në blegtori me leje të përkohshme qëndrimi sezonal si dhe 18 mijë vende të reja në bujqësi dhe 10 mijë të tjera në blegtori me leje qëndrimi të përhershme, raporton “tch”. Tashmë lejet zyrtare të qëndrimit që parashikohen edhe për punëtorët sezonalë japin mundësinë për qëndrim të ligjshëm të përkohshëm në Greqi, çka më parë ka qenë e pamundur. Vendimi i ri i qeverisë greke shënon një etapë tjetër në këtë

proces, duke zyrtarizuar tashmë statusin e tyre dhe duke krijuar vende konkrete pune. Vendi e parë për krah pune mban prefektura e Imathisë me 12 mijë leje pune, e ndjekur nga Halkidhiki me 10 dhe Pela me rreth 7 mijë leje. I rëndësishëm është fakti që pala greke dëshiron ta zyrtarizojë këtë bashkëpunim kryesisht me Shqipërinë prej nga ku është fluksi më i madh i kërkesave, jo vetëm prej afërsisë mes dy vendeve, por edhe për faktin se shqiptarët konsiderohen si punonjës të specializuar në sektorin e bujqësisë.

Gratë punëkërkuese në Kosovë, më të shkolluara se burrat



PRISHTINË, 7 SHKURT - Sipas Agjencisë së Statistikave, në Kosovë numri i grave punëkërkuese me shkollim të lartë është më i madh se numri i burrave. Të dhënat tregojnë se gratë punëkërkuese me nivelin bachelor dhe master në

dhjetor të vitit 2020 ishin 7 557, ndërsa me të njëjtin nivel të shkollimit ishin 4 370 burra. Por, pavarësisht prej nivelit më të lartë të shkollimit, punësimi i grave është në nivel më të ulët. Sipas të dhënave zyrtare, niveli i

punësimit të gratë në Kosovë është 14.4 për qind, ndërsa punësimi të meshkujt 46.2 për qind. Shkalla e papunësisë në Kosovë është rreth 30 për qind, kurse çdo vit në tregun e punës në Kosovë hyjnë deri në 25 mijë persona.

Shqyrtohet raporti për dëmet që janë krijuar nga vërshimet në Drenas

DRENAS, 7 SHKURT (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në Drenas ka mbajtur mbledhjen e parë të rregullt për këtë vit. Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapo, i ka njoftuar të pranishmit për masat e marra nga kjo drejtori për evidentimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë familjare, në bujqësi dhe në biznese dhe hartimin e raportit përfundimtar në të cilin janë evidentuar të gjitha dëmet e shkaktuara pas vërshimeve. Ajo ka treguar se raporti është

dërguar në ministrinë përkatëse me qëllim të kompensimit eventual nga fondi i caktuar për këtë çështje. Drejtoresha Krapo ka njoftuar edhe për ndërhyrjet e realizuara nga kjo drejtori pas vërshimeve dhe për bashkëpunimin e mirë me FSK-në dhe AME-në për evitimin e rrezikut të përgjithshëm. Pjesëmarrësit rekomanduan një mbikëqyrje dhe kontroll më të mirë të projekteve të cilat realizohen në Komunën e Drenasit me qëllim që në të ardhmen të mos ketë pasoja të mëdha nga vërshimet.



Buxheti i Komunës së Mitrovicës këtë vit do të jetë mbi 20 milionë euro



MITROVICË, 7 SHKURT (ER) - Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik në Komunën e Mitrovicës ka mirëpritur miratimin e draftbuxhetit për vitin 2021 në mbledhjen e jashtëzakonshme të

Kuvendit Komunal. Buxheti i komunës së Mitrovicës për vitin 2021 është 20,725,819 euro. Grandi i përgjithshëm është në vlerë 7,106,748 euro, granti specifik i arsimit 8,776,311 euro, granti specifik i

shëndetësisë 2,506,903 euro, të hyrat vetjake janë në vlerë 2,335,857 euro. Komuna e Mitrovicës ka njoftuar se ky buxhet do të shfrytëzohet drejt dhe në përputhje me kërkesat e qytetarëve.

Artistja nga Skenderaj synon ta thyjë rekordin botëror për të tretën herë

SKENDERAJ, 7 SHKURT (ER) - Artistja nga Komuna e Skenderajt, Arbnora Fejza-Idrizi, synon ta thyjë një rekord të ri botëror për të tretën herë. Komuna e cila drejtohet nga Bekim Jashari ka bërë me dije se Fejza-Idrizi është duke realizuar mozaikun më të madh në botë me flamurin e Kosovës.

“Arbnora Idrizi-Fejza me ndihmën e 25 nxënësve nga Skenderaj është duke realizuar mozaikun më të madh origami në botë, flamurin e Republikës së Kosovës”, ka njoftuar Komuna e Skenderajt. Realizimi i këtij mozaiku ndërlidhet edhe me 13-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.



Institucioni parashkollor ‘Ganimete Tërbeshi’ përfiton nga projekti i IOM-it

GJAKOVË, 7 SHKURT (ER) - Në institucionin parashkollor “Ganimete Tërbeshi” në Gjakovë është bërë inaugurimi i projektit të IOM-it në kuadër të programit për stabilizim të komuniteteve, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Komuna e Gjakovës. Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka theksuar se komuna është duke punuar vazhdimisht që t’i rrisë kapacitetet për përfshirjen sa më të madhe të fëmijëve në nivelin parashkollor. Ndërkaq përfaqësuesja e IOM-it, Albiana Çavolli, ka falënderuar Komunën e Gjakovës për bashkëpunimin e

vazhdueshëm dhe ka premtuar që projekte të tilla do të përkrahen edhe më tutje. Drejtoresha e këtij institucioni arsimor, Arta Stavileci, ka falënderuar Komunën e Gjakovës dhe IOM-in për mbështetjen e këtij projekti, duke theksuar që mbështetja e komunës është rritur gjatë këtyre viteve, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejt në jetën e fëmijëve të cilët e kalojnë një pjesë të ditës në kopsht. Kopshti “Ganimete Tërbeshi”, gjegjësisht objekti numër 2, përfitoi nga ky projekt këndin e lojërave në oborr si dhe orendi, duke përfshirë shtretër, dollapë, orendi kuzhine e të tjera.



Reagim nga Bardhyl Mahmuti

Mohimi i gjenocidit është thikë pas shpine viktimave të gjenocidit!

Në prononcimin e parë publik të Enver Hoxhajt, në cilësinë e ushtruesit të detyrës së kryetarit të PDK-së, ai mohoi gjenocidin dhe krimet serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë, duke i ulur ato në nivel të "masakrave dhe krimit kundër njerëzimit".

Si një nga themeluesit e PDK-së reagoi kundër qëndrimit të tillë dhe i kërkoi që si ushtrues i detyrës së kryetarit të partisë t'i respektojë qëndrimet zyrtare të PDK-së dhe të institucioneve të Kosovës dhe ta përdorë terminologjinë e saktë, GJENOCID, sa herë që i referohen asaj që ka bërë Serbia në Kosovë. (Këtë reagim e kanë publikuar disa media më 8 nëntor 2020).

Pas bërjes publike se në librin e tij "Ngritja e një shteti..." Enver Hoxhaj mohon gjenocidin që Serbia ka kryer kundër shqiptarëve në Kosovë, duke e cilësuar si "Përpjekje për gjenocid", prita me interes të madh ballafaqimin e tij televiziv në Pressing/T7.

Ishte moment i volitshëm që ai të tërhiqej nga terminologjia e gabueshme dhe të kërkonte falje publike për mohimin e këtij gjenocidi. Mirëpo jo vetëm që nuk kërkoi falje por, përkundrazi, në këtë ballafaqim televiziv Enver Hoxhaj shpërfaqti një arrogancë të pashoqe.

Duke rrahur gjoks se ai përfaqëson me dinjitet interesat e PDK-së, Enver Hoxhaj, me një "fizikulturë akademike", u përpoq ta zhvendosë çështjen në rrafshin akademik dhe, shprehu gatishmërinë të debatojë për këtë temë "kurdo që Akademia e Shkencës ka dëshirë të mbledhet dhe të diskutojmë rreth librit" të tij.

Fillimisht po tërheq vëmendjen se "të përfaqësohen me dinjitet interesat e një partie politike", nuk mjafton që dikush të jetë ushtrues detyre i funksionit më të lartë partiak, apo i çfarëdo funksioni tjetër partiak apo shtetëror, por duhet të prezantojë koherencë me vijën që ka përcaktuar partia.

Edhe në reagimin tim të 8 nëntorit të vitit të kaluar ia kam tërhequr vërejtjen se Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, si figurat emblematike të luftës së UÇK-së dhe themelues të PDK-së përdorin terminologjinë e saktë: GJENOCID sa herë që i referohen asaj që ka bërë Serbia në Kosovë dhe se në të ardhmen ai duhet t'i harmonizojë qëndrimet e veta me qëndrimet zyrtare të PDK-së dhe do të



përdorë terminologjinë e saktë për gjenocidin në Kosovë.

Nëse Enver Hoxhaj nuk kërkon falje publike për mohimin që i bën gjenocidit të shtetit serb, atëherë ai nuk është përfaqësues i denjë i PDK-së, ai nuk është, ashtu siç pretendon, "adresa e duhur për t'i zgjidhur problemet që ka Kosova"!

Ndërsa sa i përket "fizikulturës akademike" për ta tërhequr debatin gjetiu, po them se Enver Hoxhaj ka fat të madh që shteti i Kosovës ende nuk i ka përkufizuar qartë me ligj masat ndëshkuese kundër atyre që mohojnë gjenocidin, se nuk do të mund të sillej me foddullëk para kamerave.

Nuk ka njeri normal që mund të imagjinojë një ministër të Jashtëm të Izraelit të deklarojë se Gjermania naziste ka bërë "përpjekje për gjenocid" kundër hebrejve. Nuk ka njeri normal të imagjinojë një ministër të jashtëm të një shteti demokratike që kanë të përkufizuar në mënyrë të qartë ndëshkimin me ligj të mohimit të gjenocidit të kryer ndaj hebrejve ta kualifikoj këtë krim të shëmtuar si "përpjekje për gjenocid"!

Çështja e gjenocidit nuk është çështje numrash apo vendimesh të instancave të caktuara juridike. Çështja e gjenocidit është çështje e qëllimi që përkufizohet në mënyrë të qartë në Konventën

për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit dhe Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

Në tekstin e titulluar "Elemente të krimeve", që është dokument zyrtar i Asamblesë së Shteteve Anëtare të Statutit të Romës të Gjykatës

Penale Ndërkombëtare, (Élément des crimes, Documents officiels de l'Assemblée des États Parties au Statut de Rome de la Cour pénale internationale, New York, septembre 2002) theksohet në mënyrë të qartë se kemi krim të gjenocidit kur:

"1. Autori ka vrarë një apo më shumë persona.

2. Personi apo personat e vrarë i përkasin një grupi të veçantë kombëtar, etnik, racor ose fetar.

3. Autori kishte për qëllim të shkatërronte tërësisht ose pjesërisht këtë grup kombëtar, etnik, racor ose fetar...".

Siç shihet, edhe në rastet kur vetëm një njeri është vrarë në funksion të shkatërrimit të një grupi të veçantë kombëtar, etnik, racor ose fetar si të tillë, me normat e të drejtës ndërkombëtare penale, akti cilësohet si gjenocid. Prandaj çështja e gjenocidit nuk ka të bëjë me manipulim të statistikave, ku njerëzit shtohen dhe zbriten me veprime matematikore, me qëllim që të banalizohet "shtimi i krimeve" dhe "zbritja e jetëve të njerëzve të pafajshëm".

Plani i gjenocidit i përpiluar nga

Serbia nuk ka mbetur vetëm si "përpjekje", por është realizuar me pasoja shumë të mëdha në njerëz! Prandaj cilësimi si "përpjekje për gjenocid" në rastin e vrasjes së shqiptarëve të Kosovës është mohim i gjenocidit!

Në tekstin e lartpërmendur "Elemente të krimeve" saktësohet se në cilat raste cenimi i integritetit fizik dhe mendor cilësohet gjenocid. Sipas këtij dokumenti zyrtar të së drejtës penale ndërkombëtare kemi gjenocid nëse:

"1. Autori i krimit ka cenuar rëndë integritetin fizik dhe mendor të një personi apo të më shumë personave;

2. Ky person ose këta persona i takojnë një grupi kombëtar, etnik, racial, fetar të veçantë;

3. Autori i krimit kishte për qëllim të shkatërrojë tërësisht ose pjesërisht këtë grup kombëtar, etnik, racial fetar..."

Pa u kufizuar në format e shfaqjes, kjo sjellje përfshin aktet e torturës, të dhunimit, të dhunës seksuale, të trajtimeve çnjerëzore ose degraduese" ("Élément des crimes", Publication de la Cour pénale internationale, f. 2).

Siç shihet, edhe në rastet kur vetëm ndaj një femre të një grupi të veçantë kombëtar, etnik, racor ose fetar si të tillë ushtrohet dhunë seksuale me qëllim të cenimit të integritetit fizik dhe mendor kemi gjenocid!

Plani i gjenocidit nëpërmjet ushtrimit të dhunës seksuale nuk ka mbetur vetëm si "përpjekje", por është realizuar nga forcat serbe me pasoja shumë të mëdha në njerëz! Prandaj cilësimi si "përpjekje për gjenocid" ndaj mbi 20 mijë femrave të dhunuara shqiptare në Kosovë është mohim i gjenocidit.

Çështja e gjenocidit është çështje që godet tërë njerëzimin dhe si i tillë duhet të denoncohet kurdo qoftë.

Kualifikimi i denoncimit të gjenocidit gjatë fushatës zgjedhore në Kosovë si "goditje ndër brez" është neveritës, sepse mohimi i gjenocidit është thikë pas shpine dhjetëra mijëra familjeve shqiptare që humbën fëmijë, gra, burra dhe pjesëtarë të të gjitha moshave; mohimi i gjenocidit është thikë pas shpine për dhjetëra mijëra femra të dhunuara shqiptare dhe për një popull të tërë që përjetoi gjenocidin e planifikuar dhe të kryer nga Serbia.

P. s.:

Ata që nuk e dinë po u tregoj se akti themelues i kësaj partie ka vetëm dy nënshkrime: nënshkrimin e Hashim Thaçit dhe të Bardhyl Mahmutit, ndërkaq propozimi i emrit Partia Demokratike e Kosovës u bë nga Fatmir Limaj dhe u miratua në Konventën e parë të partisë.



Për Mitrush Kutelin

“Atdheu është atdhe, bile edhe atëherë kur të vret”.



Bedri ISLAMI

Kjo thënie është e njërit prej korifeut të letrave shqipe që, si një paradoks i habitshëm, ishte edhe një ndër bankierët më të shquar të kohës. I shpërndarë në dy emra, njëri nga bota e biznesit, Dhimitër Pasko, dhe tjetri nga madhështia e artit, Mitrush Kuteli, si mbetet ndër më të veçantët që ka pasur kjo tokë, fillimisht në kapërcyellin e viteve '30, pastaj në mesin e shekullit të shkuar, për të mbetur një ndër meteorët e tij. Ishte i jashtëzakonshëm, nga ata njerëz që të duket se kanë mbirë në këtë vend së bashku me lumenjtë, ujërat, bjeshkët, rrafshinat dhe rrafshlartat, liqenat, majat, dheun e butë; i pranishëm edhe me mungesën e tij, i dyzuar, me njërin këmbë jashtë të dashurës së botës sonë dhe, me tjetrën, në vitet që do të vijjnë; kurrë i dukshëm, por gjithmonë pamor; misterioz në heshtjen e tij dhe fërgëllues në shfaqjen; stilist si pak kush, për të mos thënë ati i stilistikës letrare dhe rrëfimtari i pazakontë; i vrullshëm si erërat e vendlindjes së tij dhe mentar si pleqtë e dikurshëm të një kohe të shkuar; fjalëpakë, por i ngrohtë dhe kjo të ngjante me bukën e sapodalë nga magjja; i kursyer në mjedise të mëdha dhe bisedues i shkëlqyer me miqtë e tij.

Ai ishte i njëjtë si Migjeni, pra i vrullshëm; i njëjtë si Lazgushi, pra gurgullues; i njëjtë si Çabej, pra i ditur; i njëjtë si Branko Merxhani, pra liberal i lindur; i

njëjtë si Petro Marko, pra rrëmbyes; e megjithatë ai ishte vetja, më shumë se asgjë tjetër, ishte vetja. I papërsëritshëm dhe në të njëjtën kohë i kudogjendur.

Koha kur ai u shfaq ishte ajo e ëndërrimtarëve dhe e përshfaqjes së një elite, fati i së cilës u ndërpre, sepse duhej ndërprerë ëndrra. Burra të shquar, studiues të ndritur, me emrat e lënë në universitetet më të njohur, dendy, kur ishin të rinj dhe patricë në vitet e mëvonshme; në një vend ku katër e pesta ishin analfabetë ata ishin drita; në një truall ku legjendat përziheshin me mjerimin, ata ishin dritëzim; në fakt ata ishin perëndimi i ardhur në një vend që kishte mbetur lindje dhe ku vlerat e Lindjes ishin shkrire duke u bërë apati, mërzi dhe trishtim.

Këto burra, që sot njihen nga të gjithë edhe vetëm me mbiemrat e tyre, ose vetëm me emrat, janë bota e ndërprerë, por sidoqoftë mbesin një botë, që më pas do të magjepsnin Kadarenë, Moikomnin, Arapin, Agollin, Xhevahirin, e, bashkë me to, tërë kombin.

Plejada e Çabejt, Budës, Demirajt, Poradecit, Fishtës, Tefta Tashkos, Migjenit, Mjedjes, Branko Merxhanit - i munguari i madh, do të ketë në mesin e saj Mitrush Kutelin, që, pasi ngriti Bankën Kombëtare nën emrin e Dimitër Paskos, shkoi të ngrinte godinën e artit të tij, që, përmes aq shumë librave, vjen edhe sot aq modern, kohas, sa që të duket se kemi të bëjmë me një vëlla të Kafkës. Një stil aq brilant, përmes një shqipe aq kumbuese dhe transmetuese nuk kishin parë letrat shqipe dhe vështirë të ndeshet edhe sot e kësaj dite.

Ata që i kanë njohur tregimet e Kutelit, apo poemën e tij të famshme, më të bukurën dhe

më kumbuese me këtë temë, “Poemi kosovar”, nuk kanë mundur kurrë t’i harrojnë.

Ai është magjepsi më i madh i prozës shqiptare. Ka sjell një prozë që nuk shter; të duket sikur është një pus i thellë nën këmbët e tua, kur në të vërtetë është një det i tërë; rrjedha e tregimeve të tij është magjepsje deri në atë pikë sa të merr me vete në fantazmagorinë e tij; të duket sikur një hyjni e fshehtë vepron ndërkohë dhe prej tyre mund të ëndërrosh gjithë botën shqiptare.

Nëse Shopenhauer-i, filozofi i madh gjerman, thoshte se “arti kërkon gjithmonë urrealitetet e dukshme”, rrëfimtari i madh Mitrush Kuteli e ka bërë këtë. Që nga shkrimi i parë dhe deri tek libri i tij i fundit gjendet ky urrealitet i dukshëm, një bashkëfajësi fjalësh që të sjell postimën, se, me njohë do të thotë me rinjohë, e kjo ndodh tek Kuteli.

E rëndë ishte mesi i jetës së Dhimitër Paskos dhe, po aq e vështirë vazhdimi i jetës së Mitrush Kutelit.

Pasko, ky atdhetar i shkëlqyer, si ishin të gjithë emrat e mëdhenj të kohës së tij, do të jetë i burgosur pas përfundimit të luftës, megjithëse e kishte dashur lirinë si pak kush tjetër dhe e kishte dashur atdheun si askush.

Kjo rëndoi edhe tek Mitrush Kuteli, i gjithëdituri, njeriu rezistent përmes heshtjes dhe krijimit, i mistershëm, pasi për të, si për Lazgushin, nuk dihej nëse ishte ende në jetë; i dukshëm, pasi, megjithë perden që kishte rënë mbi jetën e tij, ai ishte; i gjithëpranishëm, në tërë hapësirat shqipfolëse, i venduar në kohë, pasi koha dhe vetëm koha bën diferencimet e mëdha. Njeriu që arriti të shpëtojë përmes rrezikut të vdekjes një pjesë të thesarit të shtetit

shqiptar, pikërisht atëherë kur forcat gjermane po largoheshin; bankieri që ishte themeluesi i vërtetë i bankës dhe lëvruesi i qartë dhe i saktë i saj, gjeti strehimin e tij tek Mitrush Kuteli, duke ndërtuar me arkitekturën e veprave të tij një madhështi të pazakontë.

Disa fate njerëzore, si duket, janë të përcaktuara nga Hyjnitë për të qenë të tillë. Githçka që zhvillohet rreth tyre, që ndërfitet në jetën e mundimshme, mjedisi, arti, miqtë, ujërat që ndahen dhe pluhuri i tokës që ngrihet, rruga e lodhshme dhe mendja e tyre rrëqethëse për nga hijeshia, janë krijuar si në një teatër ngrihen skenat për të përgatitur ngjarjet e mëpasme.

Nuk ka ndodhur kështu vetëm me Kutelin. Ai është njëri nga autorët e brezit të tij, të cilët natyrshëm mund t’i quajmë edhe sot e kësaj dite si prijës të letërsisë sonë. E jo vetëm kaq: edhe të mendimit shoqëror.

Gjithçka që u ngrit rreth e rreth botës së Dhimitër Paskos përgatiti Mitrush Kutelin. Një jetë e pazakontë, që zë fill në Rumani, shkrihet në viset e tjera shqiptare, shkon në stepat ruse, ushtar i detyruar, skenën e luftës e të cilës e braktis gëzueshëm, sepse lufta nuk është e tij, ai do të ketë një moto të habitshme që të ngjan me një thënie të Gjonit (10:18), “Askush s’më heq jetën, unë e jap jetën”.

I dyzuar në emrin e tij, ishte e lehtë të burgosësh Dhimitër Paskon, autorin e Poemit kosovar, pikërisht në vitet e para të pas luftës, ku një Mugosh do të ishte më shumë se sa një sundimtar dhe ku verbëria ishte shndërruar në bindje e, bindja në verbëri, në një kohë kur vendi po përgatiste ekzekutimin e vetvetes, do të duhej më parë të dënonte dishepujt e lirisë, trumbetarët, të bënte harrimin

e tyre dhe harresa është guri më i madh që mund të vihet në qafën e artit.

Ky brez poetësh e mendimtarësh të dukeshin natyrshëm si fisnikë vjenezë; të kujtosh sot emrat e tyre është njëjtë si të thërrasësh në kujtesë imazhet e xhentëlmeneve të shquar, që, më shumë se sa me kostumet e tyre parisianë, do e habitnin botën me metaforat, studimet ilire, gjuhën e lashtë, gdhendjen e kujtesës së kombit, si të ishin shkruerit e lashtë egiptianë, duke ngritur piramidën e një populli që kishte filluar të harrohej.

Kuteli është simbolisti i kësaj epoke. Pakkush është aq i kapshëm, stili i tij është i vetvetishëm dhe modern, pa u dukur si i tillë, por i ndjeshëm deri në palcën e tij; vepra e tij nuk përmban asnjë lajthitje dhe ai vetë, në librat e tij nuk dremit asnjëherë. “Në një cep të Ilirisë së Poshtme” është njëri ndër librat e fundit të tij dhe ende sot nuk e kam shqitur nga vetja mahnitjen.

Ishte një kënaqësi e papërbalueshme dhe e mahnitshme nga e gjithë ajo që shfaqej para meje. Një pafajësi e pathyeshme.

Ky njeri, i patundshëm në bindjen e tij se “Atdheu është atdhe, bile edhe atëherë kur të vret”, që solli në letërsinë shqipe veprën ndër më harmoniket, që erdhi tek ne i dyzuar në emrin e tij, ku koha dhe fati kanë bërë të dimë për njërin e tjetrin, si për një njeri të vetëm, edhe kur po vdiste, pasi kishte bërë të pamundshmen dhe kishte përkthyer kolosë të letërsisë së botës, mbylli sytë, pa lënë pas vetes asnjë pasuri, veç mundimeve dhe vuajtjeve dhe moton e jetës së tij që mishërohej tek atdheu.

Sa herë që përkulem para tij, e ndiej veten më të mirë!

AZIZ KELMENDI EMËR I MADH DHE I LAVDISHËM NË HISTORINË E LUFTËS ÇLIRIMTARE KUNDËR SERBISË PUSHTUESE



Ismet SYLEJMANI

Me ditë të tëra e kamë përcjellur me emocione dhe ndjenjë të veçantë admirimi, dhembje e krenarie botimin në gazetën e famshme EPOKA E RE, e cila në 19 vazhdime, ka sjellur shkrimin e autorit Lulzim Sahiti, për shqiptarin legjendar, për emrin e lavdishëm e me nam, për figurën e madhe e me të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar që ka ndodhur nëpër kazermat antishqiptare të ushtrisë jugosllave, Heroin e Kombit Aziz Kelmendi!

Ngjarja në kazermen ushtarake të Paraqinit të Serbisë, ku u vra shqiptari patriot e atdhetar, Heroi i Kombit Aziz Kelmendi, ishte ngjarja që tronditi opinionin dhe që mobilizoi edhe më shumë rininë heroike dhe popullin shqiptar të Kosovës dhe viseve të saja në ish-jugosllavi, për veprimtari dhe organizim politiko-patriotik dhe përgaditje të luftës së armatosur kundër Serbisë pushtuese!

Nuk ka shqiptar atdhetar e patriot, që nuk është mobilizuar edhe më shumë, pas ngjarjes në kazermen ushtarake të Paraqinit ku mbeti i vrarë ushtari shqiptar, Heroi i Kombit Aziz Kelmendi dhe u burgosen e u denuan me denime të gjata një numër i madh shokësh të Aziz Kelmendit!

Rënia e të riut shqiptar në atë kohë ishte tronditje e madhe për tërë popullin shqiptar!

Emri Aziz Kelmendi, u bë tmer për çdo serb e vegël të tyre antishqiptare!

Të gjitha instancat politike të ish- Jugosllavisë titiste, të gjitha kazermat e ushtrisë jugosllave në çdo skutë të tyre, u përfshinë nga ngjarja makabre në të cilën u djeg dhe ra përtoke prestigji i armatës së republikave të ish-jugosllavisë titiste dhe deri në palcë antishqiptare!

Pas rënies së Heroit të Kombit Aziz Kelmendi nuk ka pasur familje shqiptare që kanë përcjellur bijtë e tyre në shërbimin ushtarak në ish-jugosllavi, e që nuk e kanë pritur me ankth se nuk do të ju kthehen në arkivole!

Populli shqiptar i Kosovës dhe Viseve të saja në ish-jugosllavi, birin e Tij, Heroin e Kombit Aziz Kelmendi e ngriti në pedestal dhe i dha vendin e merituar në historinë e luftës së organizuar

dhe përpjekjeve të pandërprea patriotike dhe atdhetare të shqiptarëve liridashës!

Faqet e gazetave dhe broshurave ilegale, te organizatave e grupeve atdhetare politiko-patriotike në ish-jugosllavi dhe diasporë, ishin te mbushura me shkrime ku vend te rendesisem e te vecante zinin shkrimet ne nderim e per figuren e madhe qi ishte krijuar e Heroit te Kombit Aziz Kelmendi!

Artikujt e shtypit shqiptar në Shqipëri dhe komentet rrëqethëse të Radio Tiranës dhe jehona e tyre në Kosovë, ka qenë e madhe dhe me reperkusione pozitive e për shtim të radhëve të organizuara në organizimin ilegal kundër Serbisë pushtuese!

Këngët në nderim të Heroit të Kombit Aziz Kelmendi u bënë këngët më të dëgjura e më të


preferuara të rapsodëve e folkloristëve atdhetar e patriot!

Në odat dhe në dasmat shqiptare, në mesin e këngëve të tyre të veçanta zinin vend në rreshtat e parë këngët e shumta për kryepersonazhin e kazermës jugosllave të Paraqinit, Heroin e Kombit Aziz Kelmendi!

Emri i madh dhe i lavdishëm i ushtarit shqiptar të vrarë nga kriminelet serb në kazermën ushtarake në Paraqin, u shënderrua në një rënë nga shtytjet edhe më të mëdha për të vazhduar luftën e organizuar kundër pushtimit serb dhe për të ardhur deri te lufta e armatosur e UÇK-së dhe lufta e sajë e shenjtë kundër Serbisë pushtuese dhe largimit përfundimtar të sajë nga Kosova! Lavdi jetës dhe veprës së Heroit të Kombit Aziz Kelmendi!

Prishtinë, 6 Shkurt 2021!





**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Prishtina rrëmben Kupën në të dyja konkurrencat

KB Sigal Prishtina në konkurrencën e meshkujve e fitoi Kupën, pasi në finale e mposhti Golden Eagle Yllin (76:82), kurse në konkurrencën e femrave Prishtina e mposhti në finale Bashkimin (75:71)

"Epoka e re"

SUHAREKË, 7 SHKURT - Sigal Prishtina ka fituar Kupën e Kosovës në basketboll, duke mundur Golden Eagle Yllin me shifrat 76:82 (16:27, 19:14, 27:23, 14:18).

Prishtina e nisi ndeshjen më mirë, me një seri prej 0:8, derisa epërsinë më të lartë e arritën në 11 pikë, 6:17, derisa çerekun e parë e përfunduan në të mirë të tyre 16:27. Prishtinasit vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, duke pasur epërsi 18:31, por me kalimin e minutave vendasit ngushtuan shifrat dhe pjesa e parë përfundon 35:41. Ylli vazhdoi me lojë të mirë edhe në periodën e tretë, dhe arrin që të kalojë në epërsi 60:59, kurse shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 62:64. 10 e minutat e fundit ishin mjaft interesant dhe dramatik. Therandasit afrojnë rezultatin në 66:67, por Prishtina me një seri prej 6:0, shkëputet në 66:73. Dramë u zhvillua deri në momentet e fundit, por Prishtina u tregua më e vëmendshme dhe triumfoi 76:82. Te Golden Eagle Ylli u dallua Erjon Kastrati me 22 pikë e tetë asistime, kurse te Sigal Prishtina, Nigel Johnson me 21 pikë, 7 kërcime e 13 asistime. Ndërsa KBF Prishtina ka



mundur Bashkimin 75:71 (16:14, 15:19, 16:25, 28:14), duke e fituar Kupën e Kosovës në konkurrencën e femrave. Ndeshja filloi e baraspeshuar, ku të dy skuadrat treguan dëshirë të madhe për fitore. Çereku i parë ishte i barabartë dhe këtë e dëshmon edhe rezultati i kësaj pjese 16:14. Por, në periudhën e dytë për një nuancë më të mirë ishin vashat nga Prizreni, që fituan këtë pjesë 15:19, për të shkruar në pushim me rezultat 31:33. Bashkimi vazhdoi me lojë të mirë edhe në pjesën e dytë, përkatësisht periodën e tretë, duke pasur epërsi në 14 pikë,

39:53, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 47:57. Prishtinasit nuk u dorëzuan dhe në çerekun e fundit, 6 minuta nga fundi afrojnë shifrat në 58:61. "Bardhekaltret" vazhduan me lojë të mirë, duke barazuar rezultatin dhe duke pasur epërsi në katër pikë, 69:65. Skuadra nga Prishtina arriti të menaxhojë epërsinë, duke triumfuar në fund me rezultat 75:71. Te Prishtina u dallua Alexis Tolefree me 37 pikë e pesë kërcime, kurse te Bashkimi u dalluan Aisha Ballarabe me 19 pikë e 22 kërcime dhe Saranda Daci me 14 pikë e 15 kërcime.



SHKURT

Kukësi mposhtet nga Kastrioti

Kukësi i jep fund ecurisë së rezultateve pozitive nën drejtimin e Mirel Josës. Skuadra verilindore pësoi një humbje minimale 1-0 në "Loro Boriçi". Ekipi i Kastriotit befasoi Kukësin në fundin e pjesës së parë, pasi Devidi u harrua në zonë, duke arritur që ta dërgonte topin në rrjetën e Xhikës. Në pjesën e dytë Kukësi tentoi me të gjitha mënyrat golin e barazimit. Në minutën e 73-të Shkalla la Kastriotin me një lojtar më pak pas ndëshkimit me kartonin e dytë të verdhë, por as me avantazhin numerike verilindorët nuk mundën të gjenin golin. Kukësi mbetet në vendin e 6-të me 26 pikë, ndërkohë që krutanët kanë dy pikë më pak.

Januzaj asiston në fitoren e Sociedadit

Adnan Januzaj ka asistuar një gol në fitoren e thellë 4-1 që Real Sociedadit e ka shënuar të dielën ndaj Cadizit, në xhiron e 22-të të La Ligas. Januzaj asistoi golin e tretë të shënuar nga Alexander Ishak në minutën e 54-t. Januzaj është zëvendësuar në minutën e 63-të.

Berisha shënon golin e tij të parë këtë sezon në Australi

Ish-sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Besart Berisha, ka shënuar një gol të bukur për skuadrën e tij Western United FC. Berisha u transferua tek Western Unitedi në vitin 2019, ku në 32 ndeshje ai kishte gjetur rrjetën 20 herë, por që këtë sezon ende nuk kishte shënuar. Besarti shënoi golin e tij të parë, në ndeshjen që Western Unitedi e zhvilloi si mysafir i Central Coast Mariners (3-2). Berisha shënoi golin e dytë për skuadrën e tij në minutën (42'). Pas kësaj humbje, skuadra e Westernit qëndron në vendin e 10-të në tabelë nga 12 gjithsej.

Ndërron jetë legjenda e boksit, Leon Spinks

Ka ndërruar jetë të dielën, në moshën 67-vjeçare, legjenda e boksit Leon Spinks. Spinks i kohësh vuan nga një sëmundje e rëndë, e cila ditën e sotme i ka marrë jetën, në shtëpinë e tij në Las Vegas. Ka qenë vetë bashkëshortja e tij, e cila ka konfirmuar se Spinks është ndarë nga jeta. Amerikani u bë i njohur dhe tërhoqi vëmendjen e të gjithëve në mbarë botën, kur më 15 shkurt të vitit 1978 Spinks duelonte me kampionin Muhamed Ali në ring dhe pavarësisht se ky i fundit shihej si favorit, Spinks ia doli ta mposhtë dhe i mori titullin kampion, ndonëse kishte vetëm 8 ndeshje në boksion profesionist.

Greza: Nuk largohem nga Osijeku

Futbollisti shqiptar Eros Greza ka konfirmuar se trajneri Zekiç e ka kërkuar që t'i bashkohet në Hungari. Futbollisti gjakovar ka konfirmuar se do të qëndrojë në Osijek. "Me atë trajner unë kam pasur raportet më të mira, sepse edhe suksesin më të madh e kam arritur me atë. Kemi një raport shumë miqësor. Realisht, është e vërtetë, sepse ai donte që të më ndihmonte dhe që unë të shkoja në Hungari për tre apo katër muaj. Për mua, si mundësi, që ta arrija formën time, por edhe që ta ndihmoja atë. Mirëpo, u mendova gjatë, duke e ditur që nuk jam në formën time më të mirë fizike dhe nuk e di nëse realisht mund ta ndihmoj vërtet atë. Prandaj, kam vendosur që të mos shkoj. Do të rri tek Osijeku", ka thënë Greza.

Khaka: Në Zvicër e kemi filluar me më pak se zero

LONDËR, 7 SHKURT - I fortë fizikisht, por edhe më tepër në aspektin psikologjik. Granit Xhaka ia ka dalë që të përballojë një situatë të vështirë tek Arsenalit, atje ku tifozët e kritikojnë thuasë në çdo ndeshje, shpeshherë pa të drejtë.

Mesfushori shqiptar ia doli edhe në momentin që i gjithë stadiumi me tifozët e Arsenalit nisën që të vërshellen kundër tij. Nga buron kjo forcë e Xhakës? Pa dyshim që nga e shkuara e tij. Një cilësi që i përket edhe babait, Ragipit, i cili nga viti 1986 kaloi

tre vjet e gjysmë si i burgosur politik. Më pas, kur ai doli nga burgu, familja shkoi jashtë vendit. "Në Zvicër e kemi filluar me më pak se zero. Nuk kishim asgjë dhe nuk njihnim askënd atje. Është e vështirë për njerëzit sot që ta kuptojnë këtë lloj

situatë, për të ditur se si ndihet një refugjat politik që është i ri në moshë. Pa dyshim që është pjesë e karakterit tim tani që të jem një person i fortë. Nuk kam ikur kurrë nga asgjë. Ka pasur komente nga Evra dhe Henry. Ata flasin për lojtarë të caktuar.



Disa herë këta ekspertë provokojnë me komentet e tyre, ka thënë Xhaka.

Lakersat ngritën në vendin e dytë

Los Anxhelos, 7 shkurt - Los Angeles Lakersi ngritën në vendin e dytë në Konferencën e Perëndimit falë Le Bron Jamesit. "Ylli" i kalifornianëve rezultoi vendimtar me dy trepikëshat në fund për t'i siguruar suksesin skuadrës së tij 135-129 ndaj Detroit Pistonsit pas dy kohëve shtesë. Pasi fitoi javën e kaluar ndaj Lakersit, Pistoni i bënte të vuanin të njëjtët kundërshtarë, duke rikuperuar plot 17 pikë në periodën e tretë. Madje në fundin e kohës së parë shtesë, Jerami Granti për pak realizoi pikët fituese. LeBron Jamesi mori mbi shpatulla ekipin e tij duke e mbyllur përballjen me 33 pikë, 5 "rebounde" dhe 11 asistime në 46 minuta mbi parket. Sigurisht se dy trepikëshat e fundit i dhanë goditjen përfundimtare



Detroit, raporton "Supersport"-i. Sukses i padiskutueshëm i Philadelphia 76ers ndaj Brooklyn Netsit 124-108. Pa Kevin Durantin dhe Kyrie Irvingun, që munguan për

arsye dëmtimi, skuadra njujorkeze e pati të pamundur ta përballojë furinë e vendësve, të udhëhequr nga Joel Embiid, autor i 33 pikëve. Për Netsin nuk mjaftoi James Hardeni, autor i 26 pikëve, 8 topa të kontrolluar poshtë koshit dhe 10 asistimeve. Milwaukee Bucks mori fitoren e dytë brenda dy ditësh ndaj Cleveland Cavaliersit, që këtë herë u dorëzua 99-124. Kjo ishte fitorja e katërt radhazi për ekipin e udhëhequr mbi parket nga Giannis Antetokounmpo, i cili e mbylli përballjen me 24 pikë dhe 11 "rebounde" e 5 asistime, ndërsa Jrue Holiday shtoi 20 pikë të tjera.

REZULTATET

New York Knicks - Portland Trail Blazers	110-99
Sacramento Kings - Denver Nuggets	119-114
Orlando Magic - Chicago Bulls	92-118
Atlanta Hawks - Toronto Raptors	132-121
Cleveland Cavaliers - Milwaukee Bucks	99-124
Houston Rockets - San Antonio Spurs	106-111
Oklahoma City Thunder - Minnesota Timberwolves	120-118
Philadelphia 76ers - Brooklyn Nets	124-108
Dallas Mavericks - Golden State Warriors	134-132
New Orleans Pelicans - Memphis Grizzlies	118-109
Los Angeles Lakers - Detroit Pistons	135-129

Gjyqtarët mbajnë seminar për implementimin e protokollit të sistemit VAR

PRISHTINË, 7 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës në prag të fillimit të garave të stinorit pranveror ka organizuar seminarin dyditor për gjyqtarët e Superligës dhe Ligës së Parë, në ambientet e stadiumit të "Fadil Vokrri" në të cilin ka ligjëruar instruktori i UEFA-së, Sokol Jareci. Ky seminar vjen pas testeve fizike, të cilat gjyqtarët arritën t'i kryejnë me sukses gjatë mesjavës së kaluar. "Në hap me projektin e kryetarit Ademi që VAR-i të implementohet në afatin sa më të shkurtër të mundshëm, temë bosht e këtij seminari ishte pikërisht implementimi i protokollit VAR. Tema të tjera të këtij seminari ishin edhe ndërhyrjet në zonën e 16-metërshit, bashkëpunimi & puna në grup dhe loja me dorë, ku gjyqtarët u udhëzuan mbi interpretimet më të reja të



rregullave të lojës", thuhet në njoftimin e FFK-së. Në mesjavë do të fillojnë ndeshjet e Kupës së Kosovës, për të vazhduar në fundjavë me fillimin e stinorit

pranveror në Superligë, andaj Komisioni i Gjyqtarëve siguron se gjyqtarët janë të gatshëm për përbushjen e detyrave të tyre në ndeshje.

SHKURT

Vdes legjenda e futbollit shqiptar, Milutin Kërçiç

Është ndarë nga jeta në moshën 63-vjeçare ish-futbollisti i Skënderbeut dhe ekipit kombëtar "Shpresa" Milutin Kërçiç, i cili vuante prej disa kohësh nga një sëmundje e rëndë. Milutin Kërçiç është pa dyshim një nga futbollistët më të mirë në gjithë historinë e Skënderbeut. Prej gati 30 vjetësh jetonte në Guci të Malit të Zi prej dhe nga kishte origjinën e babait. Nga viti 2010 është rikthyer edhe një herë te "Skënderbeu" pasi ish-presidenti i futbollit korçar Agim Zeqo e ka përfshirë për gati 3 sezone në stafin e ekipit. Por, rikthehet edhe një herë në vendin e origjinës aty ku dhe do të prehet.

Umtiti refuzon ofertën e Liverpoolit

Mbrojtësi i Barcelonës, Samuel Umtiti, refuzoi mundësinë për t'iu bashkuar ekipit të Liverpoolit. Francezi pati ofertë nga klubi anglez për t'iu bashkuar atyre pas problemeve të shumta në mbrojtje, por refuzoi. Ai dëshironte të luftonte për vendin e tij në formacionin e Barcelonës. Umtiti duket i kënaqur me jetesën në Barcelonë, pavarësisht se nuk po luan tek ekipi i Koemanit. Trajneri holandez i ka bërë të qartë se nuk e ka në plan, prandaj më e mira për të do të ishte që të largohej nga ekipi spanjoll.

Arteta: Jam i zhgënjyer me humbjen

Arsenali pësoi një tjetër humbje, e dhjeta në 23 javë kampionat. Ekipi i Mikel Artetës humbi 1-0 në fushën e Aston Villa. Vendësit shënuan golin e fitores që në minutën e dytë. Trajneri spanjoll i Arsenalit, Mikel Arteta, u shfaq shumë i mërzitur pas ndeshjes. "Jam jashtëzakonisht i zhgënjyer, si me humbjen dhe me mënyrën se si erdhi. Ishim skuadra më e mirë në fushë, kontrolluam çdo repart, por i lejuam të krijonin tre raste të rrezikshme për gol. Mungesa e golit? Iu afruam shumë herë barazimit, por gabonim në pasimin e fundit, gjithashtu edhe në guajtjet në portë. Ata shënuan dhe kaq mjafton për të fituar", ka deklaruar Arteta.

Solskjaer: Nuk jemi në garë për titull

Manchester Unitedi të shtunën e lëshoi nga duart në sekondat e fundit fitoren ndaj Evertonit duke barazuar 3-3 në "Old Trafford. Në një ndeshje që pati batika e zbatika për "Djajtë e Kuq", ata tani bënë një hap prapa në luftë për titullin. Pas ndeshjes, trajneri Ole Gunnar Solskjaer ka thënë se Manchester Unitedi nuk duhet të konsiderohet si konkurrent për titullin e kampionit. "Ne duhet të jemi më të mirë dhe të shohim se ku do të përfundojmë, duke shikuar në të ardhmen, ne duhet të ndalojmë së pranuar gola të lehtë. Ne nuk duhet të konsiderohemi si konkurrentë të titullit. Kjo është më shumë një gjë që po thoni ju mediat britanike", ka deklaruar Solskjaer. Aktualisht Manchester Unitedi gjendet në vendin e dytë me 45 pikë, dy më pak se Manchester City që ka edhe dy ndeshje më pak të zhvilluara.

Robbeni për herë të dytë mendon për pensionim

Arjen Robben po mendon të tërhiqet për herë të dytë nga futbollit aktiv, pas lëndimeve të vazhdueshme. Sulmuesi i krahut është pjesë e skuadrës së Goringenit, me të cilin ekip ka vetëm dy paraqitje. "Jam duke bërë gjithçka që mundem që të rikthehem nga lëndimi. Nëse në fund nuk marr rezultatet e dëshiruara, atëherë do të detyrohem të tërhiqem", deklaroi Robben. 37-vjeçari i kishte dhënë fund karrierës së tij në vitin 2018/19, për t'u rikthyer më pas sezonin e shkuar te Gronigeni.



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

CONTRACT AWARD NOTICE

The United States of America, acting through the Millennium Challenge Corporation ("MCC") and the Government of Kosovo (the "Government" or "GoK") have entered into a Millennium Challenge Threshold program agreement for Millennium Challenge Account assistance to help facilitate poverty reduction through economic growth in Kosovo (the "Threshold program agreement") in the amount of approximately 49 million USD ("MCC Funding"). The Government, acting through Millennium Foundation of Kosovo (the "MCA Entity"), intends to apply a portion of the MCC Funding to eligible payments under a contract for which procurement activities were issued. Any payments made by the MCA Entity under the proposed contract will be subject, in all respects, to the terms and conditions of the Threshold program agreement and related documents, including restrictions on the use and distribution of MCC Funding. No party other than the Government and the MCA Entity shall derive any rights from the Threshold program agreement or have any claim to the proceeds of MCC Funding. The Threshold program agreement and its related documents can be found on the MCC website (www.mcc.gov) and on the website of the MCA Entity <https://millenniumkosovo.org/>.

Activity Ref No: IC/ MFK/2020/006
Activity Name: SELECTION OF INDIVIDUAL CONSULTANT FOR Business Feasibility Review for Coaching Programme

Procurement Type & Method: IC

Contract No: IC/ MFK/2020/006

Contract Title: INDIVIDUAL CONSULTANT FOR Business Feasibility Review for Coaching Programme

Awarded To: Mysere Hoxha

Price: 400.00 Euro

Date of Award: 09 November 2020
Duration: November 09 – November 11, 2020

Scope (Summary): Independent Evaluator / Consultant is expected to evaluate the applications received under the Business Acceleration Programme

Activity Ref No: IC/ MFK/2020/010
Activity Name: SELECTION Individual Consultancy Services Environmental and Social Performance (ESP) Services

Procurement Type & Method: IC

Contract No: IC/ MFK/2020/010

Contract Title: Environmental and Social Performance (ESP) Consultant

Awarded To: Sabit Restelica

Price: 16,500.00 Euro

Date of Award: 10 December 2020
Duration: 30-Sep-2021

Scope (Summary): Full-time Environmental and Social Performance (ESP) Individual Consultant to provide services towards effective implementation of the Threshold Program comprising of Reliable Energy Landscape Project and Transparent and Accountable Governance Project and several project related activities such as: Household Investments in Energy Efficiency (PIEE), District Heating Metering (DHM), Woman in Energy (WE), Independent Power Producer (IPP), Air Quality Information Management, and Dig Data Challenge on Air Quality (Dig Data).

Activity Ref No: 2020-No.015
Activity Name: Procurement of Contract for the Construction of Household Efficiency Retrofits (HER)

Procurement Type & Method: Shopping

Contract No: 2020-No.015

Contract Title: Contract for the Construction of Household Efficiency Retrofits (HER) (Lot1- Lot6)

Awarded To:
Lot 1. Prishtina - ALFA.I
Lot 2. Peja-Gjakova - 2A Group Sh.P.K.
Lot 3. Gjiçane-Ferizaj - H&B CONSULTING SH.P.K
Lot 4. Prizren - Euro - Besi Shpk
Lot 5. North Mitrovica area - DIANA GROUP SHPK & Noli Projekt Sh.p.k. & Osmani Holding Sh.P.K.
Lot 6. South Mitrovica area - ILEAA-GR SH.P.K. & LONI Sh.p.k.

Price:

Lot 1. Prishtina - IDIQ CONTRACT Quoted Price EURO: € 24,944.39
Lot 2. Peja-Gjakova - IDIQ CONTRACT Quoted Price EURO: € 25,371.14
Lot 3. Gjiçane-Ferizaj IDIQ CONTRACT Quoted Price EURO: € 29,970.66
Lot 4. Prizren - IDIQ CONTRACT Quoted Price EURO: € 31,924.63
Lot 5. North Mitrovica area - IDIQ CONTRACT Quoted Price EURO: € 34,412.04
Lot 6. South Mitrovica area - IDIQ CONTRACT Quoted Price EURO: € 32,508.33

Date of Award: 15 January 2021
Duration: 15 July 2021

Scope (Summary): Works Requirements under IDIQ Contract relate to two specific tasks to be performed by the Contractor. One task is related to the site visit, detail measurements of building and preparation of sub-project Bill of Quantities (Service Order) and another task relates to the energy efficiency works to be provided on the specific household (Works Order).

Activity Ref No: RFP / MFK / QCBS / 2020 / No. 002
Activity Name: Procurement of Program Management Consultant for Assessment and Supervision Services for the Public Access to Judicial Information Activity (Case Management Information System "CMIS")

Procurement Type & Method: QCBS

Contract No: RFP / MFK / QCBS / 2020 / No. 002

Contract Title: Program Management Consultant for Assessment and Supervision Services for the Public Access to Judicial Information Activity (Case Management Information System "CMIS")

Awarded To: JV: Kosovo Legal Services Company L.L.C in association with B&S Europe S.A

Price: \$ 399,720.00

Date of Award: 8 January 2021

Duration: September 30, 2022, unless otherwise agreed upon by both parties.

Scope (Summary): Consultant for The Public Access to Judicial Information (PAJI) activity, implemented by the Millennium Foundation of Kosovo, aims to support the Kosovo Judicial Council (KJC) by building upon assistance provided by USAID and Norway to implement a Case Management Information System (CMIS) and using that system to improve the administration of justice in Kosovo, transparency of the rule of law institutions, as well as but also support the Kosovo Judicial Council, Kosovo Prosecutorial Council and the Ministry of Justice (MoJ) in improved communication and outreach.

NJOFTIM

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare nr.L – 016L - 016, konform nenit 112 paragrafi 1,2,3,4 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik se Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar Shala Soccer L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër unik identifikues: 810063769 dhe ka caktuar likuidatorin Femzi Bahtiri me ID: 1001062146 nga Prishtina, adresa: Rr. Agim Qela Kalabri Prishtinë me tel: 049/550-521 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që kanë interesa të përealizuara dhe raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Arben Rama shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të Bujqësisë "Abdyl Frashëri" Prishtinë.

► Shpejtimit Kurtaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

► Ardian Pintolli shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Abdyl Frasherit " Prizren .

► Erblind Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Besim Ndrecaj " Lutogllav.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçantë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

